

PKR.nr.379/17

NË EMËR TË POPULLIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Hamdi Ibrahim e Vehbi Kashtanjeva, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të akuzuarit A.B., i akuzuar për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës Kosovës - KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.204/2017, të datës 15.12.2017, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat: 04.04.2018; 10.09.2018 dhe 13.09.2018, në të cilin ishin të pranishëm: prokurori i shtetit Besa Limani, i pandehuri A.B. me mbrojtësin e tij av. B.T., me autorizim, si dhe e dëmtuara F.F., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 17.09.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.B., i biri i R. dhe H., e vajzërisë B., i lindur me ..., në P., tani me banim në F.K., lagja A., (nuk e di pjesën tjetër të adresës), me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar- baba i ... fëmijëve, i papunë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e paraburgimit prej datës 23.10.2017 deri me datë 21.03.2018**,

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e: me datën 20.10.2017, rreth orës 20:10 minuta, pasi në mënyrë tinëzore ka hyrë në banesën e të dëmtuarës, në F.K., rr. “Sh.K.”, hyrja ..., kati ..., me dashje, i shtyrë nga motivet e xhelozisë dhe me dashje që t’i shkaktoj lëndime trupore, tani të dëmtuarën F.F.së pari e ka shtrirë e pastaj nga xhepi ka nxjerrë një lidhëse të plastikës dhe me forcë ia ka lidhur duart të dëmtuarës, ndërsa lidhësen tjetër të plastikës ia ka lidhur për fyti duke e shtrënguar fortë, duke e sharë dhe kërcënuar me fjalët: “kurvë kam me ta marr jetën, tregoma të vërtetën se përndryshe t’i ma nuk ki me jetu, të ka ardh fundi”, pastaj e dëmtuara ka mohuar ti tregoj për lidhjen e saj me një person tjetër, ndërsa i pandehuri ka vazhduar me fjalët ”a po më tregon, a po të mbys”, ndërsa e dëmtuara përsëri ka mohuar duke i thënë që ta lerë rehat, derisa tani i akuzuari ia shtrënguar lidhëset, ia ka ngushtuar fytin dhe e ka sharë “ti je kurvë, kam me të mbytë, nuk e la qikën time me ma rritë një kurvë, ki shans me të lanë gjallë nëse ma tregon të vërtetën”, ku pas kësaj e dëmtuara i ka treguar se pas ndarjes me të – tani të akuzuarin, ka filluar një lidhje me dikë tjetër, ndërsa tani i akuzuari ka marrë një lidhëse tjetër të cilën të dëmtuarës ia ka lidhur në fyti, me ç rast e dëmtuara ka pësuar lëndime trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin aq sa prej hundëve nuk ka mundur të marr frymë, e pastaj nuk ka mundur të marr frymë as prej gojës, ka shpurdhë me këmbë por pastaj e ka lëshuar tërësisht fuqia dhe nuk ka mundur t’i bëjë as këto lëvizje, pastaj ka filluar t’i humbas edhe të pamurit sepse ka parë vetëm

turbullt, ka qenë pranë alivanosjes, e pastaj tani i pandehuri ia ka prerë lidhëset me gërshërë rreth qafës dhe duarve, duke e ka detyruar të dëmtuarën që t’i premttoj se nuk do ta lajmëroj në polici, përndryshe do t’ia marr vajzën e tyre,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të **neneve: 41; 45; 73 dhe 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit A.B.,** i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti**, i cili do të ekzekutohet pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **23.10.2017 deri me datë 21.03.2018.**
- Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **njëqind (100) €, si dhe pesëdhjetë (50) € për fondin e kompensimit të viktimave të krimit**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- **E dëmtuara F. (G.) F.**, nga F.K., rr. "Sh.K.", Hyrja ..., nr...., kati ..., ka heqë dorë nga kërkesa pasurore juridike, andaj nuk udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës, Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, nr. 2017 AE 1278, të datës 21.10.2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka filluar hetimin me aktvendimin PP.I.nr.204/2017, të datës 23.10.2017, për të pandehurin A.B., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të KPRK.

Pas përfundimit të hetimit, brenda afatit të paraparë me dispozitën e nenit 159, të KPPK, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.204/2017, të datës 15.12.2017, dhe ka akuzuar të pandehurin A.B., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 29.12.2017 dhe shqyrtimit gjyqësor, të datës 04.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari A.B., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pafajshëm për veprën penale si në hyrje të këtij aktgjykimi.

Në fjalën hyrëse, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se gjendja faktike si në aktakuzë do të vërtetohet nga provat e mbledhura nga policia në vendin e ngjarjes, raporti mjekësor mbi lëndimet e tani të dëmtuarës-dëshmitares F.F., fotot e lëndimeve të të dëmtuarës, SMS të bisedave telefonike te datës 21.10.2017, vërtetimi mbi marrjen e gjësendeve, lista e dëshmimeve e të njëjtës datë, raporti plotësues i datës 14.12.2017, foto

dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, e po ashtu ka propozuar edhe një provë tjetër që ka të bëjë me aktvendimin e kësaj gjykate për lëshimin e urdhrit mbrojtës, të datës 08.11.2017, i cili urdhër është lëshuar kundër të akuzuarit A.B., ndërsa viktimja e dëmtuar është F.F., duke shtuar se kjo aktakuzë është mbështetur në deklaratën e të dëmtuarës të

dhënë në polici dhe prokurori. Ndërsa, në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar se është vërtetuar gjendja faktike, se i pandehuri A.B., ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, përkatësisht ka kryer veprimet e përshkruara në dispozitivin e aktakuzës, gjendje e cila është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarës-dëshmitares F.F., e dhënë në të gjitha fazat e procedurës penale. Po ashtu, prokurori ka theksuar se edhe i akuzuari në mbrojtjen e tij ka theksuar se i pranon pjesërisht veprimet e tij në ditën kritike, duke u arsyetuar se i ka bërë nga xhelozia dhe duke thënë se ka gabuar që e ka bërë atë gjest, se ndoshta më mirë ka qenë që ta rrah të dëmtuarën, por ka bërë një budallallëk, duke pranuar se ka qenë i dhunshëm. Prokurori ka theksuar se nga raporti i policisë i datës 21.10.2017, si dhe foto dokumentacioni vërtetohet se i pandehuri për të humbur gjurmët e krimin, nga banesa ka hedhur në parking lidhëset e plastikës, pastaj nga ekspertiza mjekoligjore lidhur me lëndimet e të dëmtuarës F.F., si dhe foto dokumentacioni, vërtetohet se e dëmtuara ka marrë plagë sipërfaqësore në regjionin e qafës, si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës “jo i mbretë”, të kualifikuara si lëndime të lehta trupore, me pasoje të përkohshme për shëndetin, ndërsa nga SMS, të datës 21.10.2017, është vërtetuar se i pandehuri A. i ka shkruar të dëmtuarës fjalët “ke vdekje e keqe, po u nxike njeri, pramë tu ai fytyra, sytë ja nisen me dal edhe prapë mu dhimbte kur të pash në atë gjendje, ndërsa e dëmtuara F. i kishte shkruar “po a, më ke gjetë lojna me më provu, cila vdekje më e mirë, atëherë me kabull, edhe me kallash në mal, tash me ato plastika, qysh po don me provu”, ndërsa i pandehuri i ka shkruar “sa herë ta kam falë jetën, 5 herë ta kam falë jetën, kurse e dëmtuara ia ka kthyer “jo, zoti ma ka fal jetën”. Në fund të fjalës së saj përfundimtare, prokurorja ka theksuar se konsideron se i pandehuri është penalisht përgjegjës pasi me dashje ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes së dënimit ka propozuar që të merren parasysh rrethanat e parapara me ligj, ndërsa si rrethanë rënduese ka theksuar motivet e ulëta për kryerjen e veprës penale, shfrytëzimin e rrethanave kur e dëmtuara ka qenë vet dhe e pa mbrojtur.

E dëmtuara F.F., në fjalën e saj hyrëse, ka thënë se nuk paraqet kërkesë për kompensim dëmi, ndërsa në fjalën përfundimtare, ka përsëritur se nuk kërkon kompensim dëmi nga i akuzuari dhe ka shtuar se ky rast për të dhe për të akuzuarin është një problem i së kaluarës, se janë duke jetuar bashkë dhe se beson se në të ardhmen nuk do të kenë probleme.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B., av. B.T., në fjalën hyrëse ka deklaruar se nuk mund të qëndroi cilësimi juridik i veprës penale ashtu siç është përshkruar në aktakuzë, pasi që sipas provave, qartë vërehet se i akuzuari nuk ka pasur dashje që ta privoj nga jeta të dëmtuarën F.F., duke shtuar se sipas ekspertizës mjekoligjore tani e dëmtuara ka pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, dhe se në këtë rast aktakuza bie ndesh me vetveten sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale. Mbrojtësi ka thënë se duke u nisur nga ky fakt, nuk kemi të bëjmë me veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të KPRK, dhe se për të ekzistuar kjo vepër, duhet të plotësohen disa kushte siq janë: qëllimi i kryesit që ta privoi nga jeta personin tjetër, mirëpo papritmas ka ndonjë pengesë, nga personi i tretë, nga mjete të cilin e përdorë, apo nuk mund ta përfundoi veprën edhe pse dëshira e tij që veprën penale ta përfundoi. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se në këtë rast se e

dëmtuara F.F., ka thënë se qëllimi i të akuzuarit nuk ka qenë që ta vras atë, pasi para këtij rasti kanë pirë kafe dhe i akuzuari e kishte ditur se tani e dëmtuara ka pasur një lidhje tjetër, duke shtuar se po ta kishte pasur qëllimin që ta mbyste atë, nuk do të kishte pritur momentin që ka ndodhur në banesë, dhe se tani i akuzuari ka kërkuar vetëm të vërteten. E dëmtuara F.F., ka deklaruar se lajmërimi në polici e ka bërë më shumë për shkak të vajzës, pasi tani i

akuzuari në fillim i kishte thënë se nuk do t'ia sjellte vajzën por më vonë i kishte thënë “të shohim”. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se nxjerrja e sms, nga telefoni i tani të dëmtuarës është bërë pa kërkesë të prokurorisë për gjyqtarin e procedurës paraprake ashtu siç parasheh neni 91 dhe 92 që ka të bëjë me personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta, duke kërkuar që këtyre sms, si provë të mos u falet besimi dhe të trajtohen se janë nxjerr në kundërshtim me rregullat e kapitullit XVI, të KPPK. Përveç tjerash, mbrojtësi ka theksuar se në këtë çështje penale është plotësuar kushti ligjor i heqjes dorë vullnetare nga kryerje e veprës penale, pasi që po të kishte dashje që ta privonte nga jeta tani të dëmtuarën, i akuzuari ka mundur ta bëjë këtë gjë pa pengesa, duke shtuar se nga deklarata e tani të dëmtuarës dhe ajo re të akuzuarit është vërtetuar fakti se pas natës kritike, të nesërmen, pasi janë zgjuar nga gjumi, e dëmtuara dhe i akuzuari kanë pirë së bashku kafe, e pastaj e dëmtuara ka shkuar në punë dhe pas përfundimit të orarit të punës, rreth orës 24:00 e ka paraqitur rastin në polici, me arsyetim se nuk ka mundur ta paraqes më herët sepse ka pasur frikë se po e humb vendin e punës. Ndërsa, në fjalën përfundimtare mbrojtësi ka përsëritur thëniet e parashtruara në fjalën hyrëse duke i propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarit të merr aktgjykim lirues, me arsyetim se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale ose të ri cilësohet vepra penale dhe i akuzuari të shpallet fajtorë për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të KPRK, ta dënoj sipas ligjit dhe t'ia llogaris kohën e kaluar nën masën e paraburgimit.

I akuzuari A.B., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit, kërkon falje për atë që ka ndodhë, beson që ky rast do të mbetet i fundit dhe ka kërkuar falje për gjithçka.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, është dëgjuar e dëmtuara - dëshmitarja, i akuzuari si dhe janë administruar provat materiale, të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të paraqitura si në vijim:

- **Dëshmia e të dëmtuarës - dëshmitares F.F., e cila ka deklaruar se** raportet me tani të akuzuarin i ka rregulluar gjatë kohës sa i akuzuari ka qenë në paraburgim, ka qenë në vizitë shumë herë, duke shtuar se problemet me të akuzuarin i ka sqaruar dhe duke thënë se edhe për të- të dëmtuarën ka qenë e vështirë gjatë kohës sa ai i akuzuari ka qenë nën masën e paraburgimit, se është ndier shumë keq, e po ashtu është ndier edhe vet pak fajtores, me arsyetim se e ka njoftuar tani të akuzuarin se është njoftuar me një person tjetër dhe se ngjarja ka ndodhur për shkak të këtij njoftimi por edhe për arsye të tjera. E dëmtuara ka thënë se me tani të akuzuarin A. njihet prej rreth 6 vitesh, por asnjëherë nuk kanë mundur të bashkohen si qift, shkaku i rrethanave se A. ka pasur shumë ngarkesa nga ana e familjes së tij, duke pasur parasysh se ai ka qenë dhe është i martuar me një grua tjetër me të cilën ka ... fëmijë, të cilët nuk kanë mundur të pajtohen që A. të jetë me tani të dëmtuarën, duke shtuar se edhe përkundër kësaj ajo dhe tani i akuzuari nuk kanë mundur të bëjnë pa njëri tjetrin, edhe pse para se të ndodhë ngjarja kanë pasur mosmarrëveshje, por duke pasur parasysh se kanë një fëmijë - vajzë të përbashkët, me ç rast herë janë takuar si qift e herë si prindër. Pastaj, e dëmtuara ka thënë se e ka treguar ngjarjen dhe nuk ka dëshirë ta përsërisë

prapë, pasi këtë ngjarje e konsideron si të kaluar, ndërsa ka shtuar se me tani të akuzuarin kanë filluar nga zero dhe se xhelozia ka qenë shkaku kryesor që raportet e tyre janë keqësuar, pasi që tani i akuzuari kishte dëgjuar për një lidhje të saj dhe nga ajo ka dashur ta vërtetoi nëse kjo lidhje është e vërtetë. Po ashtu, e dëmtuara ka thënë se para se të ndodhte ky rast A. e ka pyetur nëse ka pasur një lidhje dhe se ajo në fillim e kishte mohuar shkaku që nuk donte probleme, por më vonë ia kishte treguar të vërtetën dhe kjo kishte ndodhur natën kur ka ndodhur ky rast, kur tani i

akuzuari A. ishte ndier keq, i lënduar dhe i tradhtuar dhe se nuk kishte dëshirë të përgjigjet në pyetjet se çka ka vepruar në ato momente tani i akuzuari sepse i vjen turp, duke shtuar se pasi i ka treguar A. se ka një lidhje, i njëjti ka filluar të qaj, pastaj ia ka lidhur duart me lidhëse plastike, duke e pyetur përse ia ka bërë këtë, pastaj ia ka vënë lidhësen e plastikes në qafë dhe ia ka shtrënguar, për shkak të së cilës në fillim ka mundur të flas, por disa sekonda më vonë nuk ka mundur të flas, e pastaj tani i akuzuari A. e ka këputur lidhësen e plastikës me gërshtëri, duke shtuar derisa e ka pasur të vendosur lidhësen e plastikës në qafë, ka mundur të marr frymë me gojë, duke shtuar se qëllimi i të akuzuarit nuk ka qenë që ta vras, sepse para këtij rasti kanë pirë kafe dhe tani i akuzuari e ka ditur se e ka pasur një lidhje tjetër, dhe po ta kishte pasur qëllim që ta mbys, nuk do ta kishte pritur momentin që ka ndodhur në banesë.

Në pyetje nga mbrojtësi, e dëmtuara- dëshmitarja ka thënë se po të kishte qenë i akuzuari A. djalë i keq ajo nuk do të kishte dalë me të dhe nuk do të kishte fëmijë me të, duke shtuar se prej kohës kur tani i akuzuari A. ka dalë nga burgu, ka raporte shumë të mira, i njëjti kujdeset për vajzën e tyre dhe dy fëmijët që i ka me bashkëshorten tjetër. E dëmtuara ka theksuar se këtë rast nuk e ka lajmëruar menjëherë në polici, por të nesërmen, sepse me A. i kanë qenë së bashku deri të nesërmen pas dite, pastaj ajo ka shkuar në punë nga ora 17-20 dhe kam qenë e mllëfësuar, kështu që e ka paraqitur rastin, rreth 24 orë pasi ka ndodhur ngjarja dhe se lajmërimin në polici e ka bërë më shumë për shkak të vajzës, të cilën tani i akuzuari nuk ia ka sjellë.

Po ashtu, e dëmtuara- dëshmitarja ka thënë se derisa e ka pasur plastikën rreth qafës, fyti i është terë –tharë, pastaj tani i akuzuari e ka këputur plastikën dhe ia ka sjellë një gotë ujë e pastaj kanë biseduar. E dëmtuara ka thënë se tani jetojnë së bashku me të akuzuarin.

- Raporti mjekësor, i dr. N.U., i datës 26.10.2017, për lëndimet e pësuar nga tani e dëmtuara, i cili raport vërteton se ditën kritike gjatë kryerjes së veprës nga tani i akuzuari, përkatësisht në rastin kur i pandehuri e ka lidhur të dëmtuarën me lidhëse të plastikës në fyti, e njëjta ka pësuar lëndime trupore, të cilat kanë rezultuar të jenë dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.
- Raporti i policit me të cilin vërtetohet se i pandehuri lidhëset e plastikës, i ka hedhur nga dritarja e banesës duke i humbur gjurmët, përkatësisht mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale, e të cilat policia i ka gjetur dhe sekuestruar në oborrin e ndërtesës.
- Foto dokumentacioni në të cilin qartë shihen lëndimet e shkaktuar të dëmtuarës, nga lidhësja e plastikës në qafë.

I akuzuari A.B., gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se pas rastit raportet me tani të dëmtuarën Fitnete i kanë shumë të mira dhe se veprimet të cilat i ka ndërmarrë ditën kritike kanë qenë për shkak të xhelozisë dhe nervozes në ato momente, për shkak të dashurisë ndaj saj, duke shtuar se ka pasur kundërshtime nga familja për të mos jetuar me

F., por se ai nuk i ka pranuar ato kundërshtime dhe tani jeton me të – tani të dëmtuarën. Në pyetje të prokurorit të shtetit, i akuzuari ka thënë se është e vërtetë se veprimet e tij i ka kryer nga xhelozia dhe se këto veprime i pranon pjesërisht, por jo ashtu siç akuzohet, me arsyetim se nuk mund të bëjë një gjë të tillë pasi nuk ka shpirt, duke shtuar se më përpara e mbyty veten sesa tani të dëmtuarën F., për shkakun se me të ka fëmijë dhe e do. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se ka gabuar që e ka bërë atë gjest dhe se ndoshta më mirë ka qenë ta rrah, por ka bërë një budallallëk, duke shtuar se nuk ka dashur ta mbys F., e as t'i shkaktoi lëndime trupore asaj, duke pasur parasysh se po të donte ta mbyste, aty ka pasur thika, ka

pasur gjithçka, por se qëllimi ka qenë vetëm frikësimi i saj, me qëllim që të kuptonte lidhur me lidhjen e F. me një person tjetër, të cilën gjë nuk ka mundur ta besoi. I akuzuari ka thënë se tani të dëmtuarën F. e ka lidhur me lidhëse plastike rreth qafës, por kur F. i ka thënë “hekma plastikën unë të tregoj”, ai ia ka hequr plastikën dhe kanë biseduar, duke shtuar se lidhësen e plastikës në qafë nuk e ka shtrënguar shumë dhe se lidhëset e plastikës të cilat ia ka vendosur F. në qafë, kanë qenë në banesë, e të cilat kanë mbetur aty pas montimit të komodës.

Pas vlerësimit të dëshmisë së tani të dëmtuarës - dëshmitares, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjykata vërtetoi se:

Në këtë rast është vërtetuar se i akuzuari A.B., me dashje, nga xhepi ka nxjerrë një lidhëse të plastikës dhe me forcë ia ka lidhur duart të dëmtuarës, ndërsa lidhësen tjetër të plastikës ia ka lidhur për fyti duke e shtrënguar fortë, duke kërkuar nga e dëmtuara që t’ia tregoj vërtetën, ndërsa e dëmtuara përsëri ka mohuar ndërsa i pandehuri ka vazhduar duke ia shtrënguar lidhëset, ia ka ngushtuar fytin, e kur e dëmtuara i ka treguar se pas ndarjes me të pandehurin, ka filluar një lidhje me dikë tjetër, i pandehuri ka marrë një lidhëse të tjetër dhe ia ka lidhur në fyt, duke ia shtrënguar, aq sa prej e dëmtuara nuk ka mundur të marr frymë dhe pas kësaj i pandehuri i ka prerë lidhëset me gërshërë rreth qafës dhe duarve.

Andaj, trupi gjykues ka bërë rikualifikim e veprës penale nga vepra penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës Kosovës, në veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të KPRK, pasi që në rastin konkret, trupi gjykues është bindur se i akuzuari ka dashur që përmes lëndimeve trupore të mësoj një fakt nga tani e dëmtuara, por kurrësi që ta vras atë, duke pasur parasysh faktin se tani i akuzuari i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarës deri në momentin kur e dëmtuara i ka treguar për një lidhje me një person tjetër. Po ashtu, trupi gjykues është bindur se qëllimi të akuzuarit nuk ka qenë vrasja e tani të dëmtuarës, pasi që edhe i akuzuari edhe e dëmtuara kanë theksuar se e kanë dashur njëri tjetrin dhe si rezultat i kësaj dashurie ata kanë edhe një fëmijë të përbashkët dhe se që të tre tani jetojnë së bashku.

Nga dëshmia e të dëmtuarës - dëshmitares F.F., është vërtetuar se para se të ndodhë ngjarja, me tani të akuzuarin kanë pasur mosmarrëveshje pasi që tani i akuzuari kishte dëgjuar për një lidhje të saj dhe nga ajo ka dashur ta mësoi nëse kjo lidhje është e vërtetë dhe se ajo në fillim e kishte mohuar shkakun që nuk donte probleme, por më vonë ia kishte treguar të vërtetën dhe kjo kishte ndodhur natën kur ka ndodhur ky rast, tani i akuzuari A. ishte ndier keq, i lënduar dhe i tradhtuar, tani të dëmtuarës ia ka lidhur duart me lidhëse plastike, duke e pyetur përse ia ka bërë këtë, pastaj ia ka vënë lidhësen e plastikës në qafë dhe ia ka shtrënguar, për shkak të së cilës në fillim ka mundur të flas, e pastaj tani i akuzuari A. e ka këputur lidhësen e plastikës me gërshërë, duke shtuar se derisa e ka pasur të vendosur lidhësen e plastikës në qafë, ka mundur të marr frymë me gojë, duke shtuar se qëllimi i të akuzuarit nuk ka qenë që ta vras atë, sepse para këtij rasti

kanë pirë kafe dhe tani i akuzuari e ka ditur se e ka pasur një lidhje tjetër sepse po ta kishte këtë qëllim nuk do ta kishte pritur momentin që ka ndodhur në banesë. E dëmtuara ka theksuar se këtë rast nuk e ka lajmëruar menjëherë në polici, por të nesërmen, sepse me A.in kanë qenë së bashku deri të nesërmen pas dite, pastaj ajo ka shkuar në punë nga ora 17-20 dhe ka qenë e mllëfatur, kështu që e ka paraqitur rastin, rreth 24 orë pasi ka ndodhur ngjarja dhe se lajmërimin në polici e ka bërë më shumë për shkak të vajzës, të cilën tani i akuzuari nuk ia ka sjellë.

Po ashtu, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, trupi gjykues është bazuar edhe në raportin mjekësor, të dr. N.U., i datës 26.10.2017, sipas të cilit tani e dëmtuara, ka pësuar lëndime trupore, të cilat kanë rezultuar të jenë dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Sipas raportit të policisë është vërtetuar se i pandehuri lidhëset e plastikës të cilat i ka përdorur për shkaktimin e lëndimeve trupore ndaj të dëmtuarës, i ka hedhur nga dritarja e banesës duke tentuar t'i humb gjurmët, përkatësisht mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale.

Nga foto dokumentacioni në shkresat e lëndës shihen lëndimet e shkaktuar të dëmtuarës në qafë, përkatësisht shihet vendi ku ka qenë e vendosur lidhësja e plastikës dhe gjurmët që ka lënë ajo si rezultat i shtrëngimit nga tani i akuzuari.

Po ashtu, për të vendosur si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, gjykata ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e tani të akuzuarit, i cili i ka pranuar veprimet e përshkuara në dispozitivin e aktakuzës por e ka mohuar se ka dashur ta vras tani të dëmtuarën.

Pra, nga dëshmia e të dëmtuarës, provat materiale të administruara dhe mbrojtjes së të akuzuarit, duke i analizuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit A.B., ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, prandaj të njëjtin gjykata e shpalli fajtor, pasi më parë gjeti se është penalisht i përgjegjshëm dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi ka vlerësuar dhe administruar të gjitha provat e propozuara nga palët në procedurë, trupi gjykues gjatë këshillimit dhe votimit, ka gjetur se në rastin konkret nuk plotësohen elementet e veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.8, lidhur me nenin 28 të KPRK, të paraqitur sikur në dispozitivin e aktakuzës, por plotësohen elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4, të KPRK. Andaj, gjykata në këtë rast në dispozitivin e aktgjykimit ka paraqitur faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, nga të cilat varet edhe zbatimi i dispozitës përkatëse sipas KPRK.

Në përshkrimin e aktakuzës, prokuroria e ka akuzuar A.B. se me dashje ka tentuar ta vras tani të dëmtuarën, por nuk ka arritur të bind gjykatën për këtë, pasi që, po të kishte pasur këtë qëllim, tani i akuzuari do ta vriste të dëmtuarën, për faktin se e ka pasur këtë mundësi sepse ka pasur mjetet dhe mundësinë pasi që tani e dëmtuara nuk ka mundur t'i shmangte veprimeve të tani të akuzuarit sepse e njëjta i ka pasur duart të lidhura.

Në këtë rast, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka pasur për qëllim vrasjen e tani të dëmtuarës, por siç e ka thënë i akuzuari dhe tani e dëmtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, qëllimi i të akuzuarit ka qenë që të mësoi për një lidhje të tani të dëmtuarës me një person tjetër, duke përdorur lidhëset e plastikës me të cilat të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, e në momentin kur tani e dëmtuara i ka treguar për lidhjen e saj tani i akuzuari ka këputur lidhësen e plastikës me gërshtë.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të akuzuarit se nxjerrja e SMS-ve, nga telefoni i tani të dëmtuarës është bërë pa kërkesë të prokurorisë për gjyqtarin e procedurës paraprake ashtu siç parashohin dispozitat e neneve 91 dhe 92, që kanë të bëjnë me personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta, duke kërkuar që këtyre sms, të mos u falet besimi dhe të trajtohen se janë nxjerrë në kundërshtim me rregullat e kapitullit XVI, të KPPK, gjykata ka gjetur se prokuroria nuk ka kërkuar një urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake, siç parasheh dispozita e nenit 91, të KPPK, kur gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhëroj secilën nga masat e parapara

me nenin 91, par. 2, nënpar. 2.1-2.14, të KPPK. Andaj, në këtë rast, gjykata ka vendosur që sms-et të vlerësohen si provë e pa pranueshme, mbi të cilën nuk mund të bazohet aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform neneve 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që, si rrethana lehtësuese vlerësoi: i akuzuari është baba i tre fëmijëve; është mbajtës i familjes; i njëjti ka pasur sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, duke pasur parasysh se e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin; sjelljen e mëparshme të të akuzuarit, pasi sipas shkrimoreve të Departamentit për Krime të Rënda të kësaj gjykate, i njëjti nuk ka ndonjë aktakuzë të ngritur dhe nuk ka qenë i dënuar më parë, si dhe rrethanat personale të të akuzuarit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, duke pasur parasysh se tani i akuzuari dhe tani e dëmtuara kanë një fëmijë të përbashkët dhe jetojnë së bashku. Ndërsa, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, e cila do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit. Për këtë, trupi gjykues, të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u vendos në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve: 365 të KPPK dhe **188, par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK**, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 24.09.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.379/17, datë 17.09.2018.

Sekretare juridike
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.